

VENDIM
Nr.1864, datë 11.9.2007

PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 1811, DATË 8.6.2007
“PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 18.2. 2007”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 10.9.2007, me pjesëmarrjen e:

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çato	Zv/Kryetar
Arben Ristani	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar
Fatmir Kumbaro	Anëtar
Genti Shala	Anëtar
Shkëlqim Hysi	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për korrigjimin e një gabimi material në vendimin nr.1811, datë 8.6.2007 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të vitit 2007”.

BAZË LIGJORE: Neni 29, pika 1 dhe 4 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

KQZ-ja, pas marrjes së të gjitha të dhënave zyrtare nga KZQV-të dhe vendimet përfundimtare gjyqësore, si dhe pas përfundimit të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me vendimin nr.1811, datë 8.6.2007 shpalli rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 18.2.2007.

Me shkresën nr. Ekstra Prot, datë 15.8.2007, Partia Agrare Ambientaliste pretendon se gjatë këqyrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në Buletinin e Zgjedhjeve Vendore të datës 18.2.2007, ka konstatuar një gabim në ndarjen e mandateve për këshilltarët e këshillit të bashkisë Rrogozhinë. Me vendimin nr.44, datë 13.3.2007 të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë Partia Agrare Ambientaliste ka përfutur një mandat dhe në bazë të listës shumëemërore të kësaj partie i takon z. Mustafa Hoxha, i cili merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Këshillit që nga konstituimi i tij. Ky mandat sipas Partisë Agrare Ambientaliste gabimisht i është shënuar Partisë Aleanca Demokratike.

Për sa më sipër, Partia Agrare Ambientaliste kërkon nga KQZ-ja korrigjimin e këtij gabimi material në Buletinin e Zgjedhjeve.

Nga verifikimi i vendimit nr.1811, datë 8.6.2007 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007” rezulton se, në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Rrogozhinë gabimisht Partisë Aleanca Demokratike i është shënuar 1 mandat dhe Partisë Agrare Ambientaliste 0 mandat. Në bazë të vendimit nr.44, datë 13.3.2007 të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë ky mandat i takon Partisë Agrare Ambientaliste;

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 29, pika 4 dhe nenin 2, pika 34 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Të korrigojë gabimin material në vendimin nr.1811 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 18.2.2007” në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Rrogozhinë, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

REZULTATI PËRFUNDIMTAR I ZGJEDHJEVE TË DATËS 18.2.2007 PËR KËSHILLTARË
BASHKIE, KOMUNE DHE NJËSIE BASHKIAKE

Lidhja 1

BASHKIA RROGOZHINË
RRETHI KAVAJË
QARKU TIRANË

Nr.	Subjektet që kanë paraqitur lista shumëemërore për këshilltarë	Mandate
1.	Aleanca Demokratike AD	0
2.	Bashkimi Liberal Demokrat BLD	0
3.	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar LZHK	0
4.	Lëvizja Socialiste për Integrim LSI	1
5.	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë PAA	1
6.	Partia Balli Kombëtar PBK	0
7.	Partia Demokracia Sociale PDS	0
8.	Partia Demokrate e Re PDR	2
9.	Partia Demokratike PD	3
10.	Partia Demokristiane e Shqipërisë PDK	1
11.	Partia për Drejtësi dhe Integrim PDI	1
12.	Partia Republikane Shqiptare PR	1
13.	Partia Socialdemokrate PSD	1
14.	Partia Socialiste e Shqipërisë PS	6
	Gjithsej mandate	17